

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë :

Ardian DVORANI - Kryesues
Edmond ISLAMAJ - Anëtar
Artan ZENELI - Anëtar

Në datën 29.03.2017 mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen Administrative me Nr. 11241-02808-00-2013 akti që ju përket palëve :

PADITËS: **Vilson Adriatiku**

E PADITUR: **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.**

OBJEKTI: Detyrimi i palës së paditur për të më shpërblyer pagën e një viti pune si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme:
Detyrimi për të shpërblyer pagën 5 mujore për mosrespektim të procedurës dhe afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës.
Detyrimi i palës së paditur të më paguaj shpërblimin për vjetërsi në punë, në masën e 5 muajve pagë për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme.

BAZA LIGJORE: Nenet 324, 328, 331 e vijues të K.Pr.Civile; Neni 118 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative; Kodi Doganor; VKM nr.205, datë 13.04.1999 “ Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, ndryshuar me VKM nr.686, datë 02.11.2005, VKM nr.172, datë 29.03.2006; Nenet 143 e vijues të K.Punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr.2857, datë 26.03.2012 ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shpërblejë paditësin Vilson Adriatiku me pagën e një viti për zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës, në bazë të pagës mujore në vlerën 79 440 lekë.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shpërblejë paditësin Vilson Adriatiku me 5 muaj pagë për mosrespektim të procedurës dhe afatit të njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të shpërblejë paditësin Vilson Adriatiku me 5 muaj pagë si shpërblim për vjetërsi.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin Nr.8, datë 10.01.2013 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.2857, datë 26.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me dëmshpërblimin për zgjidhje të menjëhershme, pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës, mosrespektimin e afatit të njoftimit, shpërblimit për vjetërsi e shpenzimet gjyqësore.

Ndryshimin e këtij vendimi vetëm përsa i përket kërimit për dëmshpërblimin me pagën e dy muajve, për shkak të mosrespektimit të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, duke vendosur rrezimin e padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.2857, datë 26.03.2012 e vendosjen e rrëzimit të padisë,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 63 të ligjit Nr.49, datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”

V E N D O S I

Prishjen e vendimit Nr. 8, datë 10.01.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më datë 29.03.2017

**Nr. 11241-02808-00-2013 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-837 i Vendimit (196)**